



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.642/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Neal-86” shpk & “Kupa” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-13729-05-18-2017, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës kthesë e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë*” me fond limit 14,924,015 lekë pa tvsh, procedurë e zhvilluar në datën 06.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Libohovë.

**Ankimues:**

BOE “Neal-86” shpk& “Kupa” shpk  
Lagjia Nr.2, Rruga “Adem Sheme”, Godina nr.2, Sarandë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Libohove

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”,i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3 Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.05.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-13729-05-18-2017, me objekt “Rikonstrukcion i rrugës kthesë e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë” me fond limit 14,924,015 lekë pa tvsh, procedurë e zhvilluar në datën 06.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Libohovë.

II.2. Në datën 06.07.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 12.07.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Tea-D	pa ofertë	I skualifikuar
- Zdravo	pa ofertë	I skualifikuar
- Jody Kompany	pa ofertë	I skualifikuar
- Neal-86	10,547,120	I skualifikuar

- |             |              |                |
|-------------|--------------|----------------|
| - Avduli    | 10,917,734   | I skualifikuar |
| - B-93      | 13,697,618   | I skualifikuar |
| - Bilibashi | 14,768,864.4 | I skualifikuar |

II.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Neal-86” & “Kupa” sh.p.k. është njoftuar më datë 12.07.2017 për skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se:

*Ne kriteret e vecanta per kualifikim kerkohet: Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, ose mund ti vihen në dispozicion, të paktën makineritë dhe pajisjet qe nevojiten për ekzekutimin e kontratës me dëshmi, në pronësi ose me qera, si më poshtë: i.Autobetonjere 2(dy) cope ii.Kamion vetëshkarkues, me kapacitet të paktën 7-18 ton 2(dy) cope iii.Komion me Vinc të madh mbi 18m 1(një)cope iv.Fabrikë betoni e pajisur me QKL, largësia jo më shumë se 25 km 1 (nje) cope v.Eskavator me goma 1(një)cope Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr.9 për mjetet dhe duhet të paraqesë: -Për makineritë që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqiten:-dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit) , çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni, taksat vjetore. Dokumentet si më lart, duhet të jenë të vlefshme brënda periudhës së vlefshmërisë së ofertës.*

*1. Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se per kamionin veteshkarkues me vinc, me targa SR5021B, ne pronesi te shoqerise NEAL-86 sh.p.k. nuk jane paraqitur taksat vjetore te paguara. 2. Po ashtu, per kamionin veteshkarkues me vinc me targa AA521IE, te marre me kontrate qiraje me nr. 102 rep. dhe nr. 46/2 kol. date 19.01.2016, nuk jane paraqitur takssat vjetore te paguara. 3. Per eskavatorin me goma, me targa SR6351B, i marre me kontrate qiraje me nr. 2928 rep. dhe nr. 1052/2 kol. date 11.11.2016, nuk jane paraqitur takssat vjetore te paguara. 4. fabrika e betonit e marre me kontrate qiraje me nr. 952 rep. dhe nr. 445 kol. date 09.06.2017, rezulton te jete ne dispozicion edhe te shoqerise AVDULI sh.p.k., pjesemarrese ne kete tender. Ndersa fabrika e asfalto-betonit, per te cilen eshte lidhur kontrate furnizimi me nr. 437 kol. dhe 274 rep. date 30.05.2016, nuk e ploteson kriterin qe duhet te jete ne pronesi ose me qera, sic parashikohet ne kriteret e vecanta per kualifikim, kriteret teknike, kerkesa per mjete e pajisje teknike.*

II.5. Në datën 20.07.2017 (nëpërmjet shërbimit postar) bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Neal” shpk& “Kupa” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre.

II.6. Në datën 24.07.2017 me anë të shkresës nr.1184 prot autoriteti kontraktor i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mosshqyrtimin e ankesës për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit të lejuar ligjor.

II.7. Në datën 27.07.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë me të njëjtin objekt pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr.1209/1 prot datë 09.08.2017 protokolluar me tonën me nr.1333/2 datë 18.08.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1.. Në datën 12.07.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Tea-D	pa ofertë	I skualifikuar
- Zdravo	pa ofertë	I skualifikuar
- Jody Kompany	pa ofertë	I skualifikuar
- Neal-86	10,547,120	I skualifikuar
- Avduli	10,917,734	I skualifikuar
- B-93	13,697,618	I skualifikuar
- Bilibashi	14,768,864.4	I skualifikuar

III.1.1. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues konstatohet se në datën 20.07.2017 nëopërmjet shërbimit postar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 24.07.2017, me shkresën nr.1184 prot autoriteti kontraktor i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mosshqyrtimin e ankesës për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit të lejuar ligjor.

III.1.3. Në datën 27.07.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Neal-86” sh.p.k & “Kupa” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij

ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, “Neal-86” sh.p.k & “Kupa” sh.p.k rezulton se ankesa e ankimuesit është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 20.07.2017 ndërkohë vlerësimi i ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike është kryer nga autoriteti kontraktor më datë 12.07.2017. Autoriteti kontraktor në datën 24.07.2017, me shkresën nr. 1184 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës me argumentin se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik “ të ndryshuar *strictu sensu* parashikohet se “ Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës pasi ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit më datë 12.07.2017.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor jashtë afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1 të L.P.P.-së pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e nesërme e punës pasi ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në tejkalim të afateve ligjore më datë 20.07.2017.

III.1.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Neal-86” shpk& “Kupa” sh.p.k nuk kanë respektuar afatet e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.7. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimes pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Neal-86” sh.p.k& “Kupa” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-13729-05-18-2017, me objekt “Rikonstruktion i rrugës kthesë e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë” me fond limit 14,924,015 lekë pa tvsh, procedurë e zhvilluar në datën 06.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Libohovë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1333 Protokolli, Datë 27.07.2017**

#### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**